



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Ky informim mbulon zhvillimet në Gjykatë që prej informimit më të fundit më 25 korrik, përfshirë vendimet e marra gjatë pushimeve të Gjykatës që përfunduan më 16 gusht. Gjatë periudhës së pushimeve, Gjykata ishte funksionale dhe puna vijoi në të gjitha njësitë e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Në çështjen *Salih Mustafa*, Paneli i Gjykatës Supreme më 29 korrik miratoi, pjesërisht, kërkesën e z. Mustafa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe anuloi pjesërisht Aktgjykimin e Apelit për pjesën që lidhet me dënimin e z. Mustafa me 22 vjet burgim. Paneli i Gjykatës Supreme ia ktheu Aktgjykimin Panelit të Apelit për të rishikuar dënimin e z. Mustafa bazuar në arsyetimin e dhënë në vendimin e Panelit të Gjykatës Supreme.

Më 31 korrik, Kryetarja e DHSK-së, Ekaterina Trendafilova, caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për një vendim të ri mbi dënimin e z. Mustafa, në përputhje me kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë. Paneli i Apelit përbëhet prej gjykatësve Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.

Personat e shpallur fajtorë në një proces gjyqësor kanë të drejtën e apelit të aktgjyimit dhe të kërkojnë mbrojtje juridike të jashtëzakonshme në rrethana të caktuara, siç veproi z. Mustafa në këtë rast.

Seancat rinisën këtë javë në çështjen e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Të hënën dhe të martën dha dëshmi ish-oficeri i ushtrisë së SH.B.A.-së, Stiven Rasëll (Steven Russell). Të martën pasdite, dëshmitari i 79-të i Prokurorisë dha dëshmi në sallën e gjyqit me masa mbrojtëse. Sipas përmbledhjes që u lexua në sallë, dëshmitari u kyç në UÇK rreth marsit 1998 dhe shërbeu në vende të ndryshme, ku stërviti ushtarë të UÇK-së dhe ushtroi detyrën e komandantit. Dëshmitari e përfundoi dëshminë dje. Seanca e ardhshme në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* është caktuar për të hënën, 26 gusht, në orën 09:00.

Në të njëjtën çështje, më 21 gusht, Trupi Gjyqësor miratoi pjesërisht kërkesën e Prokurorisë për konstatim gjyqësor të listës së fakteve për të cilat ka vendosur gjykata në çështjen *Salih Mustafa*, që Prokuroria beson se janë relevante edhe për çështjen *Thaçi dhe të tjerët*. Më herët këtë muaj, Trupi Gjyqësor lëshoi edhe vendime lidhur me dëshmitë e dëshmitarëve, mes të cilëve një vendim për miratimin e një mocioni të Prokurorisë për të pranuar tri deklarata dëshmitarësh pasi këta dëshmitarë të jenë paraqitur në gjykatë për t'u marrë në pyetje nga Mbrojtja.

Më 14 gusht, Trupi Gjyqësor urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit në vendime të ndara, pasi konstatoi se ekziston ende rreziku që të akuzuarit të pengojnë ecurinë e procesit gjyqësor dhe të kryejnë krime të tjera kundër personave që konsiderohen se janë kundër UÇK-së, ku përfshihen





dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore. Sa i përket z. Thaçi, Trupi Gjykes rikujton konstatimin e vet të mëparshëm se i akuzuari duket se u ka dhënë vizitorëve të paprivilegjuar informacione që kanë dalë gjatë dëshmive të dëshmitarëve të mbrojtur.

Më 21 gusht, Trupi Gjykes miratoi kërkesën e Kadri Veselit për përfundimin para kohe të përfaqësimit të tij nga mbrojtësi Ben Emerson. Gjykatësit iu referuan një letre të z. Veseli ku kërkoi tërheqjen e mbrojtësit “për shkak të prishjes së përvokueshme të marrëdhënies klient-avokat” si dhe një letre të z. Emerson, me të cilën njoftoi Administratoren për tërheqjen e tij të parakohshme si mbrojtës. Gjithashtu, gjykatësit morën parasysh edhe njoftimin e Administratores së kishte marrë një kërkesë nga z. Veseli për emërimin e z. Rodni Dikson (Rodney Dixon) si kryembrojtësin e tij të ri.

Trupi Gjykes vlerësoi se kërkesa e z. Veseli për përfundimin para kohe të përfaqësimit prej mbrojtësit përputhet me të drejtat e tij dhe se sigurohet në mënyrë të përshtatshme përfaqësimi i tij i vazhdueshëm dhe i efektshëm, duke mbajtur parasysh se ekipi i mbrojtjes përbëhet prej 11 personash, përfshirë dy mbrojtës të tjerë që kanë qenë të përfshirë në këtë çështje gjyqësore për disa kohë dhe bazuar në parashtrimin e Administratores së është në gjendje të ndërmarrë hapa për të emëruar z. Dikson si mbrojtësin zëvendësues.

Në çështjen *Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala*, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, më 26 korrik, urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Ismet Bahtijarit pasi konstatoi se ekziston ende rrezik i moderuar që z. Bahtijari të arratiset si dhe rreziku që të pengojë ecurinë e procesit dhe/ose të kryejë krime të tjera. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vendosi më tej se vetëm përmes kornizës për monitorimin e komunikimeve në objektin e paraburgimit të DHS-së mund të zvogëlohen mjaftueshëm këto rreziqe.

Më 5 gusht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Sabit Januzit. Duke mbajtur parasysh se, nëse do të lirohej, z. Januzi do të kishte motivin, mjetet dhe mundësinë për të ushtruar trysni ndaj dëshmitarit 1 për të shkurajuar pjesëmarrjen e tij në procesin gjyqësor ose për të ndikuar tek provat në mënyra të tjera, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi më tej se ekziston ende rreziku që i akuzuari të pengojë ecurinë e procesit gjyqësor dhe/ose të kryejë krime të tjera. Gjykatësja konstatoi se ekziston edhe rreziku i moderuar që z. Januzi të arratiset.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 12 gusht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi mocionet paraprake të Mbrojtjes, ku pretendoheshin mangësi në Aktakuzë, veçanërisht lidhur me akuzën e frikësimit përmes një premtimi ose dhurate apo forme tjetër përfitimi, siç përcaktohet në Kodin Penal të Kosovës.

Në çështjen *Pjetër Shala*, Paneli i Apelit, më 24 korrik, miratoi pjesërisht kërkesën e Mbrojtjes për të zgjatur afatin për dorëzimin e njoftimit për apel kundër Aktgjykimit. Paneli i Apelit rrëzoi kërkesën e mëvonshme të 8 gushtit për zgjatje të mëtejshme të afatit.





Për kontekst: Trupi Gjykues, më 16 korrik, e shpalli z. Shala fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe e dënoi me 18 vjet burgim, ku llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim. Sipas Rregullores, pala që kërkon apelim të aktgjykimit dhe/ose të dënimit, ka 30 ditë kohë për të dorëzuar njoftimin për apel, ku paraqet edhe arsyet për apel. Paneli i Apelit e ka shtyrë tani afatin për dorëzimin e këtij njoftimi deri më 2 shtator.

Mbrojtja kërkoi që afati të zgjatej më shumë, deri 30 ditë pasi të merret përkthimi zyrtar i Aktgjykimit në gjuhën shqipe, por Paneli e Apelit konstatoi se z. Shala nuk demonstroi arsye të vlefshme për zgjatje të mëtejshme, sepse përcaktimi dhe formulimi i arsyeve të mundshme për apel janë përgjegjësi e avokatëve mbrojtës, të cilët mund të punojë në anglishte. Gjithashtu, Paneli i Apelit rikujtoi se sipas Rregullores, gjykatësit mund të autorizojnë ndryshim të arsyeve për apel në mënyrë që palët, nëse dëshirojnë, të kërkojnë ndryshimin e arsyeve për apel pasi të kenë lexuar përkthimin në shqipe të aktgjykimit, me kusht që të paraqesin arsye të vlefshme sipas kësaj rregulle.

Në një përditësim dorëzuar Panelit të Apelit në fillim të këtij muaji, Administratorja njoftoi gjykatësit se përkthimi i paredaktuar i Aktgjykimit pritet të dorëzohet brenda 6 shtatorit 2024.

